Persa i perket kohezgjatjes te ndikimeve gjate fazes se ndertimit ato do te zgjasin aq kohe sa do te zgjase ndertimi, ndertimi eshte parashikuar te zgjase rreth 48 muaj. Kjo eshte koha normale qe duhet per te perfunduar se ndertuari kete objekt ne kushte normale. Kjo eshte e vlefshme ne kushte teknike, juridike e klime normale, por ne rast se do te hasen veshtiresi gjate punimeve mund te kete edhe shtyrje te afatit. Si rrjedhoje edhe ndikimet e fazes ndertimore do te zgjasin per aq kohe sa zgjasin punimet per ndertimin.



Persa i perket kohezgjatjes se funksionimit afati i shfrytezimit eshte 99 vjet.

**f.Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimeve negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.**

**Prekshmeria klimaterike e prodhimit hidroenergjitik**

Prodhimi hidroelektrik mund te jete shume me i ndjeshem ndaj ndryshimeve ne prurjet e lumenjve ssesa llojet e tjera te sistemeve ujore,si edhe eshte i prekshem nga konkurenca me perdoruesit e tjere te ujit.Psh te drejtat ujit per ujitje dhe sitemet e ujesjelles- kanalizimeve kane epersi mbi te drejtat per prodhimin hidroelektrik.Ndryshimi i klimes do te coje ne rritje te kerkeses per uje te pijshem dhe do te kete nevojje per me shume uje per ujitje ne bujqesi.

Sipas studimeve nje pakesim prej 20% i prurjeve ujore natyrore parashikohet te shkaktoje nje pakesim te prodhimit energjitik prej 60% ndersa nje rritje prej 20% parashikohet te sjelle nje rritje te prodhimit te energjise prej 40%.

Ndryshimet ne flukset maksimale lumore kane efekte te drejtperdrejta ne projektimin e hidrocentraleve te vegjel.Tani per tani efektet e ndryshimit te klimes nuk merren ne konsiderate ne projektimin dhe planifikimin e hidrocentraleve.

**Prekshmeria lidhur me sigurine e energjise dhe sherbimin**

Deri tani ekziston nje mungese drejtpeshimi midis ofertes dhe kerkeses per energji ne Shqiperi .Kerkohet te merren ne konsiderate efektet e ndryshimit te klimes ne cekuilibrin midis ofertes dhe kerkeses.Humbje ne sistem qe jane mbi standartin.Rritje e shkarkimit te ujit ne hidrocentrale per shkak te rritjes se rreshjeve ekstreme shkakton nje humbje te drejteperdrejte te prodhimit te energjise kosto dhe humbje te drejtperdrejta financiare.

Ngjarjet klimaterike ekstreme shkaktojne qe sistemi energjitik te mos jete ne nje suate normale shfrytezimi dhe shkaktojne humbje me te larta ne transmetim.

Njeri prej problemeve me te rendesishem te identifikuara eshte keqadministrimi i tanishem i burimeve ujore ne Shqiperi nga komuniteti.Ndryshimi i klimes mund te coje ne rritje te rrezikut te konflikteve midis perdoruesve te ujit per shkak te rritjes se kerkeses dhe paksimit te burimeve ujore te gateshme.

**g.Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.**

Investitori, me aktivitet ne fushen e shfrytezimit te energjise hidro ka investuar dhe disponon mjetet e nevojshme per shfrytezim te HEC Shini.

**Organizimi**

HEC do te jete nene administrimin e shoqerise investitore dhe do te kete nje administrator,drejtues teknik,specialiste,punetore mirembajtje te linjave te marrjes se ujit,shofere dhe roje te ketyre objekteve etje.Ne hidrocentral do te punohet me tre turne,ndersa muajt e evres do te kete reduktim te prodhimit te energjise per mungese te prurjeve dhe per realizimin e remonteve.

Masat e sigurimit teknik ne pune jane shume te rendesishme dhe do te zbatohen me perpikemer nga shoqeria.



### Mbrojtja e mjedisit

Hidrocentrali do te zhvillohet ne harmoni me velerat e natyres. Brigjet dhe shpatet e maleve perbejne habitate potenciale per biodiversitetin e pasur qe mbartin.

Ndertimi i veprave kerkon realizimin e shume punimeve

Vemendje kryesore gjate ketyre punimeve duhet te trgohet ne dy aspekte:

1. Sistemimi i materialit inert te krijuar nga keto punime
2. Sistemimi i shpateve per te evituar fillimin e erozionit.

Studimi i hollesishem i strukturave gjeologjike qendrushmerise se tyre dhe masave te porpozuara nga projektuesit jane garanci qe keto probleme mjedisore do te jene minimale.

Mund te themi se ky aktivitet nuk pritet te kete ndikim mjedisor te matshem pasi:

- Nuk ka prodhim te mbetejeve te rrezikshme
- Nuk shkakton ndotje te tokes me shkarkime te ndryshme te lengeta apo te ngurta
- Nuk ka shkarkime ne ajert te gazrave apo tymrave
- Zhurmat ne mjediset e punes do te jen brenda nmormave te lejuara
- Jane parashikuar marrja e te gjitha masave per mbrojtjen ne pune dhe masat per evitimin e rrezikut te zjarrit.

### Masat e marra per zbutjen e rrezikut ne mjedis dhe shendet

Sic e theksuam dhe me lart mund te themi se rreziku ne mjedis ne zonen qe do te realizohet projekti i ndertimit te hidrocentralit eshte minimizuar deri ne ate shkalle sa mund te themi se nuk do te jete prezent. Punimet per ndertimin e tunelit, kanalit te derivacionit, godines se turbinave etj, do te jete konform cilesise dhe satndarteve nderkombetare.

### Masat per rigjenerimin e siperfaqes gjate ndertimit dhe shfrytezimit

- Krijimi i siperfaqeve per mbjellje te reja e gjelberime
- Sistemimi i materialit te mbuleses dhe te sterileve qe dalin gjate ndertimit
- Mbjellje e siperfaqeve te reja
- Mirembajtja e siperfaqeve te mbjella
- Sistemimin i skarpateve
- Sistemimi i dherave te gjeneruara nga germimet

### Investimet e parashikuara

#### Preventivi i punimeve

Preventivi per realizimin e punimeve ne kete hidrocentral është hartuar duke patur parasysh kushtet dhe largësitë e materialeve të ndërtimit. Llogaritja e volumeve është bërë bazuar në projektet e cdo nën objekti. Theksojmë se volumet janë të përafërta, ato do të saktësohen në pershtatje me kushtet konkrete qe mund te rezultojne gjate fazes tjeter.

Cmimet e pranuar në këtë preventiv janë bazuar në listën e cmimeve standarte të Drejtorisë së përgjithshme të rrugëve, për punimet e kryera në vitin 2015 në objekte të ngjashme.

Nga preventivi rezulton se:

<b>Vlera e ndërtim Montimit është</b>	<b>340</b>	<b>Miljon Lekë</b>
<b>Vlera e përafërt e paisjeve hidroelektromekanike është</b>	<b>82</b>	<b>Miljon Lekë</b>
<b>Vlera e perafert e shpronësimeve është</b>	<b>0.5</b>	<b>Miljon Lekë</b>
<b>Vlera e perafert e punimeve te rehabilitimit te Mjedisit është</b>	<b>2.6</b>	<b>Miljon Lekë</b>



**Duke pranuar një kurs këmbimi të Euros me 136 Lekë,  
Vlera e investimit rezulton **3.1 Miljon Euro.****

**Treguesit specifike Energjitike të këtij Hidrocentrali janë si më poshtë:**

- |  |                       |
|--|-----------------------|
| <input type="checkbox"/> <b>Kostoja për fuqinë e vendosur</b>          | <b>1556 Euro/kw</b>   |
| <input type="checkbox"/> <b>Kostoja për energjinë mesatare vjetore</b> | <b>0.339 Euro/kwh</b> |



### **h. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.**

#### **Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te ndertimit dhe shfrytezimit**

Territori ku zhvillohet aktiviteti gjithmone ka nevojë për rikonstruksione sistemime gjelberime e tj. Në të gjitha rastet nderhyrjet do të përmirsojnë mjedisin dhe do të minimizojnë ndikimet. Kështu që subjekti asnjehere nuk do të lere mbas dorë rehabilitimin e zonës si dhe sistemin e saj. Me përfundimin e ndertimit të objektit menjehere do të bëhet heqja e mbeturinave ndertimore dhe këto materiale do të mbledhen dhe do të transportohen në vende të caktuara nga Njësia Administrative. Do të bëhet sistemimi i terrenit, zbulimi dhe mbjellja e territorit me bimësi në mënyrë që edhe shkurret apo disa pemë të prera për ndertimin e HEC-it të zëvendësohen.

#### **Rehabilitimi i elementeve të peisazhit**

Në të gjitha rastet kur verëhet: prerje e drurëve për ndertim, hedhje të dheut në anët e rrugës dhe gërryerje të mundshme, pronari i objektit detyrohet që të realizojë mbjellje të bimëve dhe në rastin e dherave të kryejë sheshimet e duhura dhe mbjelljen e tyre me bimësi lokale. Kjo gjë do të ndihmonte ndjeshëm në eliminimin e dëmtimeve dhe rehabilitimin e peisazhit.

#### **Heqja e kores së tokës**

Rekomandojmë, që sado e hollë të jetë kjo kore dhe sado e pakët qoftë sasia e dheut të hequr, ai duhet të grumbullohet në vende të caktuara, ku nuk ka veprimtari. Dheu përbehet në një masë të madhe nga mbeturina vegjetale të pasura me lëndë organike dhe mund të përdoret me vone gjatë rehabilitimit të zonave.

#### **Kushtet e punës**

Investitori ka krijuar kushte të favorshme pune për punonjësit e tij. Për të përmbushur sigurinë e punësve ofron kushte të mira pune, ambient të bollshëm dhe duke përdorur lëndë të kontrolluara dhe pa efekte anësore. Punëtorët janë të pajisur me uniformë dhe maska gjatë proceseve të punës, zbatohet me rigorozitet rregullorja e higjenes së vendit të punës. Stafit është me eksperiencë në këto fushë. Janë marrë masa për sigurimin teknik.

#### **Ndriçimi i objektit**

Furnizimi i objektit me rrymë elektrike bëhet nga rrjeti elektrik i pushtetit lokal dhe në raste avarie me motogjenerator. Kabllot elektrike janë të vendosur në tuba çeliku për një siguri më të lartë dhe për të rritur masat ndaj zjarrit.





### **Mbrojtja nga zjarri**

Ne zbatimin e gërmes b, te nenit 34, te Ligjit Nr.8766 date 05.04.2001 “Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin”, jane marre masat e nevojshme per mbrojtjen ne raste rreziku apo renie zjarri.

Per nje siguri maksimale ne ambientet e punes nga drejtuesit e saj, jane marre te gjitha masat per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri. Brenda objektit jane vendosur ne vende te dukshme paisje te mbrojtjes nga zjarri, si dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike. Per mbrojtjen nga Zjarri jane marre masat e meposhtme:

- Ka fikese zjarri me kapacitet 50 kg (pluhur fosil dhe gaz karbonik).
- Ka nje depozite uji
- Ka rregullore te brendshme per mbrojtjen ndaj zjarrit.
- Personeli eshte i instruktuar me rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit.
- Hyrja per ne objekt ka hapësire te konsiderueshme per automjetet e zjarrfikeseve.

### **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne perfundimisht ne ndertimin e HEC-it me sa me pak ndikime negative ne mjedisin e zones.

### **Plani i menaxhimit të mjedisit**

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet. Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme. Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim mjedisor i detajuar dhe një program trajnimi.



**Përbërësit kryesorë të këtij programi per menaxhimin e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:**

- Informacion i përgjithshëm;
- Mirëkuptim i informacioni të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë;
- Përdorimi i pajisjeve/aparatura të Certifikuara sipas Standartit European dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.
- Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria
- Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga kompani të licensuara
- Per sa I perket zhurmave,duhet te respektohet niveli i lejuar i zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;
- Funksionimi;
- Arsytet për propozimin e masave zbutëse;
- Vendosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendim marrja;

### **Plani i Përballimit të Emergjencave**

Shoqëria Koka në veprimtarinë e saj, për aktivitetin “**Ndertim I HEC-it Shini**”, detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

#### **Shoqëria ka për detyrë:**

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e AKM, ISHMP dhe Njesise Vendore për një rrezik imediat dhe AKU-në për marrjen e masave të menjëhershme.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

**Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:**



### **Rënia e zjarrit**

Në rastin e rënies së zjarreve, në territorin e Shoqërisë është e afishuar skema e lajmërimit. Mbi bazën e kësaj skeme personeli që ndodhet në Shoqëri vepron duke bërë njoftimin e PMNZSH në numrat e zjarrfikëseve të afishuara në tabelat përkatëse.

Brenda aktivitetit do të funksionojë edhe lidhja telefonike dhe telefonat celulare që janë vendosur në dispozicion për lajmërimin e zjarrfikësve. Personeli present bazuar në skemën e afishuar vepron menjëherë me fikset e dorës dhe tenton të kufizojë përhapjen e mëtejshme të zjarrit. Pajisjet dhe instalimet do të mbrohen me sistemin e shkumës antizjarr, si dhe shuarës zjarri portable dhe të lëvizshëm, të vendosur në vende të sigurta.

### **Evakuimi i detyruar i njerëzve në rast zjarri**

Pozicioni i objekteve/instalimeve është i tillë që jo vetëm respekton largësitë e mbrojtjes nga zjarri, por në rast zjarri është i zgjidhur edhe evakuimi i detyruar i njerëzve dhe mjeteve prej tyre.

### **Rënia nën tension**

Duke u nisur nga specifika që ka puna, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga rënia nëntension e paisjeve dhe e personelit që punon aty. Dhe për këtë rast janë parshikuar veprimet e menjëhershme që do të kryhen.

### **Nga tërmetet**

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe bazamentet ku janë instaluar pajisjet, nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për instalimin, objektet, personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit.

### **Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës**

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë për të zëvendësuar pemet e prera për ndertimin e HEC-it.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat e percaktuara në raportin teknik.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikset.
- Të kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoje ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.



- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e njesise vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem si gjatë fazës së operimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

### **Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis**

Monitorimi i mjedisit ka per qellim qe nepermjet matjeve sistematike, vzhgimit, dhe raportimit ta paraqese ndryshimin e gjendjes se treguesve mjedisore qe te perberesve te mjedisit. Ne perгатitjen e programit te monitorimit specialistet do te marrin ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Gjate zhvillimit te aktivitetit do te zbatohet nje plan monitorimi per mjedisin. Ky plan do te hartohet per te monitoruar hap pas hapi te gjitha ndikimet ne mjedis. Plani i monitorimit do te konsistoje:

- Monitorimin e cilesise se ajrit
- Monitorimin e cilesise se ujerave nentokesore
- Monitorimin e ndikimeve te veprimtarise ne mjedisin perreth dhe elementeve te tij.
- Monitorimin e zbatimit te rregullave te sigurimit teknik.
- Monitorimin e nivelit te zhurmave ne objekt.
- Monitorimin e nivelit te pluhurave gjate ndertimit te HEC-it.
- Monitorimi i mbetjeve te ngurta inerte

Mbetjet e gjeneruara gjate zhvillimit te procesit depozitohen ne vende provizore te percaktuara nga drejtues te subjektit dhe me pas ne menyre periodike keto mbetje te ngurta largohen per ne vendgrumbullimin e percaktuar nga pushteti vendor ose riperdore per qellime te ndryshme nga drejtues te shoqerise.

**Efektet pozitive te aktivitetit ne menyre te permbledhur do te jene:**

- Sistemimi ne pune i disa banoreve.
- Nga pikepamja teknike dhe mjedisore ky impiant i ri dhe i pavarur i gjenerimit te energjise elektrike do te jete nje risi dhe zgjidhje tekniko mjedisore pararoje.

**Konkluzione**

- Ky objekt nuk prodhon dhe nuk do te emetoje lende te demshme per mjedisin te atij niveli qe mund te vinin ne diskutim funksionimin e tij.
- Nuk do te kete:zhurma, vibracione, nxehtesi, rrezatime e tj. qe mund te shkaktojne ndikime ne hapësire.
- Njerezit qe do te punojne ne kete HEC do te kene mjete mbrojtese.
- Nuk do te kete ndikime mbetese qe mund te shfaqin efektet e tyre negative
- ne mjedis me kalimin e kohes.
- Ne rast nderprerje perfundimtare te aktivitetit, eshte e mundeshme qe territori mund te perdoret per qellime te tjera pa patur pasoja nga veprimtaria para ardhese, ne drejtim te mjedisit.

**Rekomandime**

- Kujdes duhet treguar ne shkarkimet ne ujera per mos te ndryshuar rrjedhen ujore per te cilat duhet te merren masa te menjehershme.
- Investimi i kryer, nuk do te kete efekte negative ne mjedise dhe nuk ka premisa per ndotjen e ambientit mbi normen e lejuar apo te sjelle pasoja negative ne mjedis.
- Ky aktivitet nuk perdor lende helmuese, te ngurta, te lengeta ose te gazta, te cilat po te shkarkohen ne ambient demtojne mjedisin.
- Mbjellja me peme dhe sistemimi i hapësirave do te permiresoje ne menyre te dukshme nga ana estetike ambientin ekzistues.
- Mbajtja paster e mjedisit nga kontributi i vete punonjesve do te garantoje nje mjedis te paster ne territorin e ketij aktiviteti.
- Duhet treguar kujdes per parandalimin e rreziqeve nga erozioni i tokes e duhen marre masa te menjehershme per kete problem.

**i. Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar ( nese projekti ka natyre te tille).**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit as te shteteve fqinje, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.


**Autore te hartimit te Raportit Paraprak te VNM-se**

Ing. Gjeolog Xhevair DERMYSHI

Msc. Ing. Mjedis Jozefina KINI

Msc. Ing. Mjedis Gerta Zenelaj





Për  
Koka

Mark  
Jot

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

MINISTRI

Ethem RUKA

[Handwritten signature]  
STUDIOPROJEKT  
SH.P.K.  
TIRANE-ALBANIA



QKL + QKR

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,  
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

**LICENCË**

**QKL**

IN:2652-01-2011 NUIS/NIPT: L03614803Q

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë  
Veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedisin (1) - Ndikim mjedisor (2)  
Ndikim në mjedis)

Subjekti: Eko-Studio-Projekt  
Adresa: Tirane, Kavajë, Golem, Golem, Godinë private, pranë shkollës së mesme Golem  
Kodi: III.2.A.14.2 Kod tjetër:  
Data e lëshimit: 11/02/2010 Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kufizime specifike  
Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike  
Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë  
Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënskrimi i sportelit: *Arta Bani*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E EKONOMISË,  
TREGTISË DHE ENERJITIKES  
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

**OKR**

**NUMRI SERIAL**  
L03614803Q

**NUMRI I LICENCËS**  
L03614803Q

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E EKONOMISË,  
TREGTISË DHE ENERJITIKES  
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

**OKR**

**ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI**

Personitë të tatueshëm:  
Eko-Studio-Projekt – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

Statusi:  
Aktiv

Me adresë kryesore:  
Tirane, Golem, Godinë private, pranë shkollës së mesme Golem

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):  
L03614803Q

Afati i veprimtarisë:  
Nga: 10/12/2010 deri

DATA E REGJISTRIMIT  
14/12/2010

DATA E LËSHIMIT  
14-12-2010

SPORTELI I SHËRBIMIT:

QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

*Arta Bani*

**NUMRI SERIAL**  
L03614803Q

**NUMRI I LICENCËS**  
L03614803Q

Kjo certifikatë shërben vetëm si Qendër Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji (Emri, Mbiemri) i sipërmëndtur në sportel.  
Kjo certifikatë mbetet në fuqi vetëm nëse është regjistruar në sportel.





Certifikata ISO 9001+ Certifikata ISO 14 001

**AQSCERT**  
CERTIFICATE

FOR  
QUALITY MANAGEMENT SYSTEM EN ISO 9001:2008  
(PER SISTEMIN E MANAXHIMIT TE CILESISE EN ISO 9001:2008)

Certificate No: AQS/Q/S892015

Name of company / Emri i kompanisë: **"Eko-Studio-Projekt" sh.p.k.**

Address / Adresa: Godine private, prane shkollës së mesme Golem, Golem, Albania.

Standard: **EN ISO 9001:2008**

Concerning the following EN ISO 9001:2008 for services  
(Eshtrë në përputhje me standardin EN ISO 9001:2008 në fushat e mëposhtme të aktivitetit)

"Providing laboratory services for analysis and environmental monitoring"

"Oferta shërbimesh laboratorike për analiza dhe monitorim mjedisor."

Validity of the certificate / Vlefshmëria e certifikatës	First issued / Emisja e parë	Issued / Emisja	Re-issued / Rishpallje	Expiry date / Data e skadencës
05/10/2015	05/10/2015	05/10/2015	05/10/2015	05/10/2018

DA, IAF, ACP, AQSCERT logos and accreditation details.

**AQSCERT**  
CERTIFICATE

FOR  
ENVIRONMENTAL MANAGEMENT SYSTEM EN ISO 14001:2004  
(PER SISTEMIN E MANAXHIMIT TE MJEDISIT EN ISO 14001:2004)

Certificate No: AQS/A/S902015

Name of company / Emri i kompanisë: **"Eko-Studio-Projekt" sh.p.k.**

Address / Adresa: Godine private, prane shkollës së mesme Golem, Golem, Albania.

Standard: **EN ISO 14001:2004**

Concerning the following EN ISO 14001:2004 for services  
(Eshtrë në përputhje me standardin EN ISO 14001:2004 në fushat e mëposhtme të aktivitetit)

Consultancy and assistance in the design and implementation of environmental projects.

- Support for the device with permission / license environment.
- Environmental monitoring and drafting of respective documents

Konsulentë dhe asistencë në hartimin e zbatimit e projekteve mjedisore.

- Asistencë për pajisjen me leje/licensë mjedisi.
- Monitorim mjedisor dhe hartim i dokumentacionit përkatës.

Validity of the certificate / Vlefshmëria e certifikatës	First issued / Emisja e parë	Issued / Emisja	Re-issued / Rishpallje	Expiry date / Data e skadencës
06/20/2015	06/20/2015	06/20/2015	06/20/2015	06/20/2018

DA, IAF, ACP, AQSCERT logos and accreditation details.